



**UNIVERSITETI - UNIVERSITY**  
**“ISA BOLETINI”**  
**MITROVICË**

---

**Niveli Bachelor | Të gjitha fakultetet dhe programet**

Viti akademik 2025/2026 | Cikli i vlerësimit: Janar 2026

**Mitrovicë, 2026**

| Fusha                    | Përmbajtja                                                                 |
|--------------------------|----------------------------------------------------------------------------|
| <b>Institucioni</b>      | Universiteti "Isa Boletini" në Mitrovicë                                   |
| <b>Objekti</b>           | Vlerësimi i studentëve për mësimdhënien, lëndën dhe burimet                |
| <b>Fushëveprimi</b>      | Niveli Bachelor; të gjitha fakultetet, programet, lëndët dhe mësimdhënësit |
| <b>Periudha</b>          | Viti akademik 2025/2026; cikli i Janarit                                   |
| <b>Burimi bazë</b>       | Raporti statistikor i eksportuar më 13.07.2026                             |
| <b>Njësia e analizës</b> | Përgjigjet e konsoliduara në nivel universiteti                            |

## Përmbajtja

1. Përmbledhje ekzekutive
  2. Konteksti, qëllimi dhe pyetjet e analizës
  3. Metodologjia dhe cilësia e të dhënave
  4. Panorama institucionale
  5. Analiza sipas dimensioneve
  6. Analiza e detajuar e pohimeve
  7. Angazhimi i studentëve dhe besnikëria ndaj programit
  8. Sinteza e komenteve të hapura
  9. Konkluzionet institucionale
  10. Rekomandimet dhe plani i veprimit
  11. Korniza e monitorimit
- Shtojca.** Matrica e plotë e rezultateve dhe shënimet teknike

## 1. Përmbledhje ekzekutive

Vlerësimi institucional paraqet një perceptim përgjithësisht shumë pozitiv për cilësinë e mësimdhënies dhe organizimin akademik në nivel Bachelor. Mesatarja e përgjithshme e 20 pohimeve është 4.22 nga 5, ndërsa 83.9% e përgjigjeve janë në kategoritë “Pajtohem” ose “Pajtohem plotësisht”. Rezultati është i qëndrueshëm në pothuajse të gjitha fushat, me një përjashtim të qartë: përfshirja e ekspertëve të jashtëm në lëndë.

| 4.22 / 5                 | 83.9%              | 91.7%                        | 74.7%                        |
|--------------------------|--------------------|------------------------------|------------------------------|
| Mesatarja e përgjithshme | Përgjigje pozitive | Do të regjistroheshin sërish | Studiojnë së paku 3 orë/javë |

### Gjetjet kryesore

- Forca më e konsoliduar është klima etike dhe respektuese: pohimi për sjelljen profesionale arrin 4.33/5 dhe 87.3% përgjigje pozitive.
- Syllabusi dhe planifikimi vlerësohen lart: shpërndarja e syllabusit dhe zhvillimi i testeve sipas planit janë ndër treguesit më të mirë.
- Shembujt e lidhur me teorinë, ndërlidhja ligjëratë-ushtime dhe pjesëmarrja aktive tregojnë një bazë të mirë pedagogjike.
- Hapja ndaj ekspertizës së jashtme është prioriteti më i qartë: 3.79/5, vetëm 69.1% pozitiv dhe 19.1% negativ.
- Komentet e hapura konfirmojnë vlerësimin pozitiv, por kërkojnë më shumë praktikë, shpjegime më të qarta e më të ngadalta, materiale më të përmbledhura, respektim të orarit dhe transparencë në vlerësim.

### Vendimet e rekomanduara për nivelin institucional

1. Miratimi i një standardi minimal: së paku një ligjëratë nga ekspert i jashtëm ose aktivitet ekuivalent për lëndët ku kjo është pedagogjikisht e përshtatshme.
2. Vendosja e mekanizmit të mbylljes së ciklit: çdo njësi të publikojë çfarë u dëgjua, çfarë u vendos dhe çfarë u realizua pas vlerësimit.

## 2. Konteksti, qëllimi dhe pyetjet e analizës

Ky raport është një dokument institucional me të dhënat e marra nga pyetësi me studentët. Fushëveprimi përfshin të gjitha fakultetet, programet, lëndët dhe mësimdhënësit e nivelit Bachelor - Janar 2026.

### Qëllimet

- Të vlerësojë nivelin e përgjithshëm të përvojës mësimore dhe organizimit akademik.
- Të identifikojë pikat e forta që duhet të ruhen dhe praktikatat që mund të standardizohen.
- Të evidentojë fushat prioritare ku nevojiten masa institucionale ose analiza të thelluara.
- Të lidhë rezultatet me veprime, përgjegjësi, afate dhe indikatorë monitorimi.

### Pyetjet drejtuese

1. Sa pozitiv është perceptimi i përgjithshëm i studentëve?
2. Cilat fusha dallohen si pika të forta dhe cilat si boshllëqe?
3. A përputhen rezultatet e mbyllura me temat e komenteve të hapura?
4. Çfarë vendimesh duhet të merren në nivel universiteti dhe çfarë duhet deleguar te njësitë akademike?

### LEXIMI I DUHUR I RAPORTIT

Rezultatet paraqesin perceptimin e studentëve, jo një matje të drejtpërdrejtë të performancës akademike. Ato duhen kombinuar me monitorimin e mësimin, rezultatet e të nxënësve, progresin e studentëve dhe evidencat e njësive akademike.

## 3. Metodologjia dhe cilësia e të dhënave

### 3.1 Burimi dhe përpunimi

Burimi është raporti statistikor i gjeneruar nga sistemi i universitetit SMU. Për 20 pyetjet Likert janë përdorur pesë alternativa nga 1 ("Nuk pajtohem fare") deri në 5 ("Pajtohem plotësisht"). Për secilin pohim janë llogaritur mesatarja e ponderuar, përqindja pozitive (4+5), neutrale (3) dhe negative (1+2).

### 3.2 Denominatorët


| Elementi              | Totali në burim | Trajtimi analitik                                |
|-----------------------|-----------------|--------------------------------------------------|
| Numri i respondentëve | <b>4,004</b>    | Raportohet si metadata e burimit                 |
| Çdo pohim Likert      | <b>4,004</b>    | Përdoret për përqindjet dhe mesataret e pohimeve |
| Orët e studimit       | <b>4,004</b>    | Përdoret për shpërndarjen e orëve                |
| Regjistrimi përsëri   | <b>4,004</b>    | Përdoret për përqindjen Po/Jo                    |

### 4. Panorama institucionale

Në totalin e 80,080 përgjigjeve të regjistruara në 20 pohime, mesatarja është 4.22/5. Përgjigjet pozitive përbëjnë 83.9%, përgjigjet neutrale 11.1% dhe përgjigjet negative 5.0%. Kjo tregon një bazë të fortë kënaqësie, por edhe hapësirë për ta shndërruar vlerësimin “Pajtohem” në përvojë të qëndrueshme të nivelit “Pajtohem plotësisht”.

#### Figura 1. Renditja e të gjitha pohimeve

*P18 për ekspertët e jashtëm ndahet qartë nga grupi i rezultateve të tjera.*



*Burimi: Raporti statistikor i UMIB-së, Janar 2026; llogaritje të autorit mbi totalët e eksportuara.*

## LEXIMI DREJTUES


Dallimi ndërmjet pohimit më të lartë dhe më të ulët është 0.55 pikë. Kur përjashtohet P18, pohimet e tjera janë brenda intervalit 4.18-4.33, çka tregon vlerësim të lartë, por edhe dallime të dobishme për prioritizim.

## 5. Analiza sipas dimensioneve

Për ta bërë raportin të përdorshëm për menaxhim, pohimet janë grupuar në gjashtë dimensionë analitike. Ky grupim është ndërtuar për këtë raport dhe nuk paraqet shkallë zyrtare të validuar të instrumentit.

### Figura 2. Mesataret sipas dimensioneve

*Pesë dimensionë janë mbi 4.22/5; dimensionin e ekspertizës së jashtme është qartë nën nivelin institucional.*



*Burimi: Raporti statistikor i UMIB-së, Janar 2026; llogaritje të autorit mbi totalët e eksportuara.*

| Dimensioni                       | Mesatarja | Pozitive | Negative |
|----------------------------------|-----------|----------|----------|
| Ndërveprimi dhe të nxëniti aktiv | 4.28      | 85.4%    | 3.7%     |

|                                   |             |       |       |
|-----------------------------------|-------------|-------|-------|
| Rregullsia dhe zbatimi akademik   | <b>4.25</b> | 85.4% | 4.0%  |
| Organizimi, syllabusi dhe burimet | <b>4.24</b> | 84.3% | 4.5%  |
| Dizajni dhe koherenca mësimore    | <b>4.22</b> | 83.8% | 4.4%  |
| Vlera e perceptuar dhe zgjedhja   | <b>4.22</b> | 84.0% | 5.3%  |
| Hapja ndaj ekspertizës së jashtme | <b>3.79</b> | 69.1% | 19.1% |

*Shënim: Mesataret dimensionale janë mesatare të thjeshta të pohimeve përbërëse. Grupimi është analitik dhe jo pjesë e instrumentit burimor.*

### 5.1 Pikat e forta institucionale

| Forca                               | Evidenca                     | Implikimi                                                                          |
|-------------------------------------|------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Etika dhe respekti akademik</b>  | <b>4.33/5; 87.3% pozitiv</b> | Të ruhet si standard bazë dhe të përfshihet në orientimin e stafit të ri.          |
| <b>Syllabusi në javën e parë</b>    | <b>4.32/5; 87.2% pozitiv</b> | Të standardizohet modeli i syllabusit dhe evidenca e shpërndarjes në SMU.          |
| <b>Shembujt e lidhur me teorinë</b> | <b>4.29/5; 86.0% pozitiv</b> | Të mbledhen dhe ndahen praktikrat e mira ndërmjet departamenteve.                  |
| <b>Pjesëmarrja aktive</b>           | <b>4.29/5; 86.2% pozitiv</b> | Të forcohen format që nxisin pyetje, diskutim dhe bashkëpunim.                     |
| <b>Testet sipas planit</b>          | <b>4.29/5; 86.8% pozitiv</b> | Të vazhdojë monitorimi i harmonizimit mes syllabusit dhe kalendarit të vlerësimit. |

### 5.2 Fushat prioritare

| Prioriteti                        | Evidenca                     | Përgjigjja e kërkuar                                                                |
|-----------------------------------|------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Ekspertët e jashtëm</b>        | <b>3.79/5; 19.1% negativ</b> | Prioritet institucional i drejtpërdrejtë; planifikim, buxhet dhe partneritete.      |
| <b>Harmonizimi teori-praktikë</b> | <b>4.18/5; 5.2% negativ</b>  | Më shumë detyra autentike, laborator, raste dhe projekte të lidhura me profesionin. |


|                                                 |                                        |                                                                           |
|-------------------------------------------------|----------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------|
| <b>Përfshirja e<br/>sugjerimeve në syllabus</b> | <b>4.20/5; 12.8%</b><br><b>neutral</b> | Mekanizëm i dukshëm për konsultim dhe dokumentim të ndryshimeve.          |
| <b>Mbikëqyrja<br/>praktike/laboratorike</b>     | <b>4.20/5; 12.2%</b><br><b>neutral</b> | Rishikim i kapaciteteve, protokolleve dhe pranisë mbikëqyrëse.            |
| <b>Materialet në SMU</b>                        | <b>4.22/5; 5.5%</b><br><b>negativ</b>  | Standard minimal për ngarkim në kohë, strukturë dhe qasje të materialeve. |

## 6. Analiza e detajuar e pohimeve

Struktura e përgjigjeve tregon se mbështetja pozitive është e gjerë, jo vetëm produkt i mesatareve. Megjithatë, përqindjet neutrale janë sinjal i dobishëm për fushat ku studentët nuk kanë përvojë të njëtrajtshme ose nuk e shohin qartë zbatimin.

### Figura 3. Përbërja pozitive, neutrale dhe negative


*P18 ka pjesën më të lartë negative; P11 ka nivelin më të lartë neutral.*



*Burimi: Raporti statistikor i UMIB-së, Janar 2026;*

### Figura 4. Harta e prioriteteve

*Pohimet lart-majtas kombinojnë mesatare më të ulët me pakënaqësi më të lartë.*



*Burimi: Raporti statistikor i UMIB-së, Janar 2026;*

## 6.1 Matrica e rezultateve sipas pohimit

Pohimet janë renditur sipas numrit të instrumentit. Për lexim të shpejtë, “pozitive” bashkon përgjigjet 4 dhe 5, ndërsa “negative” bashkon përgjigjet 1 dhe 2.

| #  | Pohimi                                                                               | Mes. | Poz.  | Neu.  | Neg. |
|----|--------------------------------------------------------------------------------------|------|-------|-------|------|
| 1  | Materiali i ligjëratave dhe ushtrimeve ishte i qartë dhe lehtë i kuptueshëm          | 4.22 | 82.9% | 12.7% | 4.4% |
| 2  | Metodat e mësimdhënies kanë qenë bashkëkohore dhe të përshtatshme për temat e lëndës | 4.25 | 85.1% | 10.8% | 4.1% |
| 3  | Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është harmonizuar                       | 4.18 | 82.0% | 12.8% | 5.2% |
| 4  | Mësimdhënësi/ja inkurajon diskutim dhe bashkëpunim gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve  | 4.26 | 85.1% | 10.9% | 4.0% |
| 5  | Ligjëratat dhe ushtrimet kanë qenë ndërvepruese                                      | 4.21 | 82.6% | 13.2% | 4.2% |
| 6  | Mësimdhënësi/ja ka ofruar shembuj të lidhur me teorinë                               | 4.29 | 86.0% | 10.2% | 3.8% |
| 7  | Mësimdhënësi/ja ka nxitur pjesëmarrjen aktive dhe shprehjen e lirë të ideve          | 4.29 | 86.2% | 10.4% | 3.5% |
| 8  | Mësimdhënësi/ja ka promovuar sjellje etike, respektuese dhe marrëdhënie kolegjinale  | 4.33 | 87.3% | 9.6%  | 3.1% |
| 9  | Mësimdhënësi/ja ka sqaruar dhe shpërndarë syllabusin në javën e parë                 | 4.32 | 87.2% | 9.2%  | 3.5% |
| 10 | Të gjitha materialet e lëndës/ligjëratave janë dërguar në SMU                        | 4.22 | 83.0% | 11.5% | 5.5% |
| 11 | Sugjerimet e studentëve për ndryshime janë marrë parasysh dhe përfshirë në syllabus  | 4.20 | 82.3% | 12.8% | 4.8% |

| #  | Pohimi                                                                                      | Mes. | Poz.  | Neu.  | Neg.  |
|----|---------------------------------------------------------------------------------------------|------|-------|-------|-------|
| 12 | Aktivitetet e lëndës janë vlerësuar sipas syllabusit dhe janë përfshirë në vlerësimin final | 4.24 | 84.5% | 11.5% | 4.0%  |
| 13 | Ligjëratat kanë qenë të ndërlidhura me ushtrimet                                            | 4.25 | 85.3% | 10.7% | 4.0%  |
| 14 | Profesorët/asistentët e respektojnë orarin e ligjëratave                                    | 4.27 | 85.9% | 10.0% | 4.1%  |
| 15 | Profesorët/asistentët e respektojnë orarin e konsultimeve                                   | 4.26 | 85.7% | 10.3% | 3.9%  |
| 16 | Puna laboratorike/praktike mbikëqyret vazhdimisht nga mësimdhënësi/asistenti                | 4.20 | 83.2% | 12.2% | 4.5%  |
| 17 | Testet janë mbajtur sipas planifikimit në syllabus                                          | 4.29 | 86.8% | 9.6%  | 3.6%  |
| 18 | Në lëndë është ftuar të paktën një profesor/ekspert i jashtëm                               | 3.79 | 69.1% | 11.8% | 19.1% |
| 19 | Studenti do t'ua rekomandonte lëndën studentëve të tjerë                                    | 4.21 | 83.5% | 11.4% | 5.0%  |
| 20 | Studentët janë të lirë të përcaktohen për lëndët zgjedhore                                  | 4.23 | 84.5% | 9.9%  | 5.6%  |

Burimi: Raporti statistikor i UMIB-së, Janar 2026; llogaritje të autorit mbi totalët e eksportuara.


## 7. Angazhimi i studentëve dhe besnikëria ndaj programit

Dy pyetjet plotësuese japin informacion për investimin individual të studentit dhe gatishmërinë për të zgjedhur përsëri të njëjtin program. Të dy treguesit janë të favorshëm, por nuk duhet të interpretohen si matje e drejtpërdrejtë e rezultateve të të nxënës apo e mbajtjes faktike të studentëve.

### Figura 5. Studimi jashtë mësimi dhe zgjedhja e programit

Tre në katër studentë raportojnë së paku 3 orë studim në javë; nëntë në dhjetë do të regjistroheshin përsëri.

#### Orët javore të studimit jashtë mësimi të regjistrohej sërish në të njëjtin program



Burimi: Raporti statistikor i UMIB-së, Janar 2026;

### Interpretimi

- 42.1% raportojnë 3-4 orë studim në javë, kategoria më e madhe.
- 32.5% raportojnë 5 ose më shumë orë; ky grup mund të analizohet më tej sipas fushës së studimit dhe ngarkesës ECTS.
- 25.3% raportojnë vetëm 1-2 orë; pa ndarje sipas lëndës dhe ECTS nuk mund të përcaktohet nëse kjo paraqet rrezik apo natyrë specifike të ngarkesës.
- 91.7% do të regjistroheshin përsëri në të njëjtin program, sinjal i fortë i përshtatjes dhe besimit; 8.3% "Jo" mbetet grup i rëndësishëm për analizë të shkaqeve.

## 8. Sintezë e komenteve të hapura

Komentet e hapura u shqyrtuan si evidencë cilësore. Përfundimet më poshtë pasqyrojnë temat që përsëriten dhe përputhen me rezultatet sasiore.

### 8.1 Çfarë vlerësojnë studentët

| Tema pozitive                          | Sintezë institucionale                                                                |
|----------------------------------------|---------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Qartësia dhe kuptueshmëria</b>      | Shpjegime të qarta, ligjërata të kuptueshme dhe disponueshmëri për sqarime.           |
| <b>Profesionalizmi dhe korrektësia</b> | Përgatitje profesionale, respekt, komunikim i mirë dhe sjellje kolegjiale.            |
| <b>Atmosfera mbështetëse</b>           | Qasje bashkëpunuese dhe hapësirë për pyetje e pjesëmarrje.                            |
| <b>Ndërlidhja teori-praktikë</b>       | Vlerësim pozitiv kur shembujt, ushtrimet dhe puna praktike lidhen me teorinë.         |
| <b>Rregullsia</b>                      | Respektim i orarit dhe organizim i parashikueshëm në rastet e vlerësuara pozitivisht. |

### 8.2 Çfarë kërkojnë të përmirësohet

| Tema për përmirësim                  | Sintezë institucionale                                                               |
|--------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Më shumë praktikë dhe shembuj</b> | Rritje e aktiviteteve praktike, laboratorike, rasteve dhe aplikimit profesional.     |
| <b>Më shumë ndërveprim</b>           | Më shumë diskutim, bashkëpunim dhe kohë për pyetje pas prezantimeve.                 |
| <b>Ritëm dhe qartësi</b>             | Shpjegime më të ngadalta, më të detajuara dhe fokus më i mirë në konceptet kryesore. |
| <b>Materiale më të strukturuar</b>   | Materiale më të përmbledhura, më pak të shpërndara dhe më të organizuara në SMU.     |
| <b>Orari dhe zëvendësimet</b>        | Respektim më i qëndrueshëm i orarit dhe kompensim i orëve të                         |

|                                |                                                                                          |
|--------------------------------|------------------------------------------------------------------------------------------|
|                                | humbura.                                                                                 |
| <b>Vlerësimi</b>               | Kërkesë për kritere të qarta, paanshmëri, kontroll korrekt dhe harmonizim me syllabusin. |
| <b>Mbështetja e studentëve</b> | Më shumë qasje, mirëkuptim dhe orientim për studentët që hasin vështirësi.               |

### 8.3 Trajtimi i komenteve të ndjeshme

Një numër i kufizuar komentesh përmban pretendime për rregullsinë, paanshmërinë ose praktikën e vlerësimit. Këto nuk mund të verifikohen nga anketa dhe nuk duhet të konsiderohen fakte të provuara. Ato duhet të kalojnë në një proces konfidencial të filtrimit, verifikimit dhe trajtimit sipas procedurave institucionale, pa ekspozuar studentët apo personelin në raportin publik.

## 9. Konkluzionet institucionale

**1. Cilësia e perceptuar është e lartë dhe e qëndrueshme.** Mesatarja 4.22/5 dhe 83.9% përgjigje pozitive tregojnë se baza e përvojës mësimore është solide.

**2. Kultura profesionale është një aset institucional.** Etika, respekti, planifikimi dhe zbatimi i syllabusit janë ndër fushat më të vlerësuara.

**3. Hapja ndaj ekspertizës së jashtme është boshllëku kryesor.** P18 është i vetmi tregues që bie ndjeshëm nën grupin e rezultateve të tjera dhe ka 19.1% përgjigje negative.

**4. Përmirësimi duhet të fokusohet në përvojën konkrete të të nxëniet.** Komentet kërkojnë më shumë praktikë, ndërveprim, qartësi, materiale të strukturuar dhe ritëm të përshtatshëm.

**5. Vlerësimi dhe rregullsia kërkojnë kontroll të vazhdueshëm.** Edhe kur treguesit janë të lartë, komentet sinjalizojnë se përvoja nuk është plotësisht uniforme.

**6. Besnikëria ndaj programeve është e fortë, por jo universale.** 91.7% do të regjistroheshin përsëri; grupi 8.3% "Jo" duhet kuptuar sipas programit dhe vitit.

**7. Sistemi i raportimit duhet të kalojë nga agregimi te diagnostikimi.** Pa ndarje sipas njësive dhe pa normë përgjigjeje, drejtimi nuk mund të lokalizojë boshllëqet ose të masë përfaqësueshmërinë.

**8. Cikli duhet të mbyllet me veprim dhe komunikim.** Vlera e anketës rritet kur studentët shohin ndryshime të dokumentuara dhe njësitë raportojnë progres.

## 10. Rekomandimet dhe plani i veprimit

Rekomandimet janë renditur sipas urgjencës dhe ndikimit. Afatet janë propozuese dhe duhet të harmonizohen me kalendarin akademik dhe strukturën organizative të universitetit.

| Pr<br>i. | Masa                                    | Veprimi                                                                              | Përgjegjësi                    | Afati                                   | Indikatori                                                     |
|----------|-----------------------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------|--------------------------------|-----------------------------------------|----------------------------------------------------------------|
| P<br>1   | <b>Programi i ekspertëve të jashtëm</b> | Hartim standardi, databazë partnerësh dhe plan për angazhimin e ekspertëve në lëndë. | Prorektori për mësim / Dekanët | Deri në fillim të semestrit të ardhshëm | % e lëndëve të përshtatshme me së paku 1 aktivitet             |
| P<br>1   | <b>Standardi i materialeve në SMU</b>   | Afat, strukturë minimale, nomenklaturë dhe kontroll i disponueshmërisë.              | Dekanët / Departamentet        | Brenda 3 muajve                         | % e lëndëve që përmbushin standardin                           |
| P<br>1   | <b>Transparenca e vlerësimit</b>        | Rubrika/kritere, kthim informate, evidencë e kontrollit dhe kanal ankese.            | Senati / Njësitë akademike     | Brenda 1 semestri                       | % syllabuseve me kritere të plota; ankesat e trajtuara në afat |
| P<br>2   | <b>Zhvillimi pedagogjik</b>             | Module për ndërveprim, qartësi, ritëm, praktikë dhe strukturim të materialeve.       | Qendra për zhvillim akademik   | Gjatë vitit 2026/27                     | Pjesëmarrja; ndryshimi në P1-P7 dhe komentet tematike          |
| P<br>2   | <b>Mbyllja e ciklit të feedback-ut</b>  | Çdo njësi publikon “Dëgjuam - Vepruam - Rezultati”.                                  | Zyra e cilësisë / Dekanët      | Pas çdo cikli                           | % e njësive me plan dhe raport progresi                        |
| P<br>2   | <b>Protokolli për</b>                   | Filtrim, anonimizim, triagim dhe verifikim                                           | Zyra e cilësisë /              | Brenda 2 muajve                         | Protokoll i miratuar; rastet e                                 |

| Pr<br>i.       | Masa                                                     | Veprimi                                                            | Përgjegjësi             | Afati                   | Indikatori                                  |
|----------------|----------------------------------------------------------|--------------------------------------------------------------------|-------------------------|-------------------------|---------------------------------------------|
|                | <b>komentet e<br/>ndjeshme</b>                           | konfidencial.                                                      | Sekretariati            |                         | trajtuara sipas<br>afatit                   |
| <b>P<br/>3</b> | <b>Analiza e<br/>studentëve<br/>që zgjedhin<br/>"Jo"</b> | Shtim pyetjeje për<br>arsyen dhe analizë<br>sipas programit/vitit. | Zyra e<br>cilësisë      | Cikli i<br>ardhshëm     | Shkaqet kryesore<br>dhe plan i synuar       |
| <b>P<br/>3</b> | <b>Seria<br/>kohore<br/>institucionale</b>               | Ruajtje e definicioneve<br>dhe krahasim<br>semestral/vjetor.       | Zyra e<br>cilësisë / TI | Nga cikli i<br>ardhshëm | Trend 3-ciklesh<br>për secilin<br>indikator |

## 11. Korniza e monitorimit

Për të kaluar nga raportimi statik te menaxhimi i cilësisë, universiteti duhet të ndjekë një grup të vogël indikatorësh të qëndrueshëm dhe t'i analizojë sipas njësive, duke ruajtur konfidencialitetin.

| Indikatori                             | Pragu orientues                    | Ritmi     | Ndarja minimale                |
|----------------------------------------|------------------------------------|-----------|--------------------------------|
| <b>Mesatarja e përgjithshme Likert</b> | $\geq 4.20$                        | Semestral | Universitet, fakultet, program |
| <b>Përqindja pozitive</b>              | $\geq 85\%$                        | Semestral | Dimension dhe pohim            |
| <b>Përqindja negative</b>              | $< 5\%$ ; alarm kur $\geq 10\%$    | Semestral | Dimension dhe pohim            |
| <b>Ekspertiza e jashtme (P18)</b>      | $\geq 4.10$ dhe $< 8\%$ negativ    | Vjetor    | Fakultet/program               |
| <b>Materialet në SMU (P10)</b>         | $\geq 4.25$                        | Semestral | Program/lëndë                  |
| <b>Regjistrimi përsëri - Po</b>        | $\geq 90\%$ ; analizë kur $< 85\%$ | Vjetor    | Program/viti                   |
| <b>Norma e përgjigjes</b>              | $\geq 40\%$ ose prag i miratuar    | Çdo cikël | Fakultet/program/viti          |
| <b>Planet e veprimit të mbyllura</b>   | $\geq 80\%$ në afat                | Tremujor  | Njësi përgjegjëse              |

**Shtojca A. Matrica e plotë numerike**

Tabela paraqet numrin e përgjigjeve për secilën alternativë. Çdo rresht ka total 4,004 përgjigje.

| #  | Pohimi                                                                               | 1   | 2   | 3   | 4     | 5     |
|----|--------------------------------------------------------------------------------------|-----|-----|-----|-------|-------|
| 1  | Materiali i ligjëratave dhe ushtrimeve ishte i qartë dhe lehtë i kuptueshëm          | 81  | 95  | 508 | 1,510 | 1,810 |
| 2  | Metodat e mësimdhënies kanë qenë bashkëkohore dhe të përshtatshme për temat e lëndës | 66  | 98  | 433 | 1,585 | 1,822 |
| 3  | Raporti ndërmjet pjesës teorike dhe praktike është harmonizuar                       | 72  | 136 | 512 | 1,560 | 1,724 |
| 4  | Mësimdhënësi/ja inkurajon diskutim dhe bashkëpunim gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve  | 60  | 100 | 437 | 1,538 | 1,869 |
| 5  | Ligjëratat dhe ushtrimet kanë qenë ndërvepruese                                      | 62  | 105 | 530 | 1,559 | 1,748 |
| 6  | Mësimdhënësi/ja ka ofruar shembuj të lidhur me teorinë                               | 54  | 98  | 410 | 1,511 | 1,931 |
| 7  | Mësimdhënësi/ja ka nxitur pjesëmarrjen aktive dhe shprehjen e lirë të ideve          | 52  | 87  | 415 | 1,547 | 1,903 |
| 8  | Mësimdhënësi/ja ka promovuar sjellje etike, respektuese dhe marrëdhënie kolegjiale   | 46  | 79  | 384 | 1,474 | 2,021 |
| 9  | Mësimdhënësi/ja ka sqaruar dhe shpërndarë syllabusin në javën e parë                 | 60  | 81  | 370 | 1,485 | 2,008 |
| 10 | Të gjitha materialet e lëndës/ligjëratave janë dërguar në SMU                        | 101 | 119 | 461 | 1,447 | 1,876 |
| 11 | Sugjerimet e studentëve për ndryshime janë marrë parasysh dhe përfshirë në syllabus  | 60  | 134 | 513 | 1,550 | 1,747 |

| #  | Pohimi                                                                                      | 1   | 2   | 3   | 4     | 5     |
|----|---------------------------------------------------------------------------------------------|-----|-----|-----|-------|-------|
| 12 | Aktivitetet e lëndës janë vlerësuar sipas syllabusit dhe janë përfshirë në vlerësimin final | 64  | 97  | 460 | 1,592 | 1,791 |
| 13 | Ligjëratat kanë qenë të ndërlidhura me ushtrimet                                            | 70  | 89  | 428 | 1,609 | 1,808 |
| 14 | Profesorët/asistentët e respektojnë orarin e ligjëratave                                    | 72  | 91  | 401 | 1,545 | 1,895 |
| 15 | Profesorët/asistentët e respektojnë orarin e konsultimeve                                   | 68  | 89  | 414 | 1,602 | 1,831 |
| 16 | Puna laboratorike/praktike mbikëqyret vazhdimisht nga mësimdhënësi/asistenti                | 80  | 102 | 489 | 1,613 | 1,720 |
| 17 | Testet janë mbajtur sipas planifikimit në syllabus                                          | 59  | 86  | 385 | 1,588 | 1,886 |
| 18 | Në lëndë është ftuar të paktën një profesor/ekspert i jashtëm                               | 298 | 467 | 471 | 1,321 | 1,447 |
| 19 | Studenti do t'ua rekomandonte lëndën studentëve të tjerë                                    | 85  | 117 | 458 | 1,542 | 1,802 |
| 20 | Studentët janë të lirë të përcaktohen për lëndët zgjedhore                                  | 134 | 91  | 396 | 1,479 | 1,904 |

Burimi: Raporti statistikor i UMIB-së, Janar 2026. Shkalla: 1=Nuk pajtohem fare; 5=Pajtohem plotësisht.

### Shtojca B. Formulatat dhe definicionet

| Termi               | Definicioni                                                                                                  |
|---------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| Mesatarja e pohimit | $\Sigma (\text{vlera e alternativës} \times \text{numri i përgjigjeve}) / \text{numri total i përgjigjeve}.$ |

|                                 |                                                                                         |
|---------------------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Përqindja pozitive</b>       | $(\text{Pajtohem} + \text{Pajtohem plotësisht}) / \text{totali} \times 100.$            |
| <b>Përqindja neutrale</b>       | $\text{Mesatarisht} / \text{totali} \times 100.$                                        |
| <b>Përqindja negative</b>       | $(\text{Nuk pajtohem fare} + \text{Nuk pajtohem}) / \text{totali} \times 100.$          |
| <b>Mesatarja institucionale</b> | Mesatarja e ponderuar mbi të gjitha përgjigjet e 20 pohimeve.                           |
| <b>Dimensionet</b>              | Grupe tematike të krijuara për këtë raport; nuk janë shkallë psikometrike të validuara. |

### Shtojca C. Prioritetet për ciklin e ardhshëm të dhënave

- Kodimi i strukturuar i komenteve dhe largimi i përgjigjeve boshe/jo-substanciale.
- Shtimi i pyetjeve ndjekëse për arsyt e mos regjistrimit përsëri.
- Dokumentimi i planeve të veprimit dhe statusit të zbatimit në të njëjtin panel.

### Shtojca D. Fushat minimale të panelit institucional

| <b>Bloku</b>                 | <b>Përmbajtja minimale</b>                                                                |
|------------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>Identifikimi i ciklit</b> | Viti akademik, semestri, data e hapjes/mbylljes dhe versioni i instrumentit.              |
| <b>Struktura akademike</b>   | Fakulteti, programi, niveli, viti i studimit dhe departamenti.                            |
| <b>Përfaqësueshmëria</b>     | Studentët e ftuar, përgjigjet valide, norma e përgjigjes dhe pragjet e anonimitetit.      |
| <b>Rezultatet</b>            | Mesatarja, pozitive/neutrale/negative, ndryshimi nga cikli i kaluar dhe sinjali i pragut. |
| <b>Komentet</b>              | Tema e koduar, statusi i pastrimit, niveli i ndjeshmërisë dhe rruga e trajtimit.          |